




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. D-p. D-p.	2-D/DPK
Nr. ltaq. d-uy stranica Nr. pages	03
Nr. Prot. Br. Prot. Prot No.	01-1174/15
Data Datum Date	20.04.2015
PRISHTINË	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 20.04.2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

I, Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-4502-15 për znj. Arta Tahiri-Këshilltare në Kuvendin Komunal të Ferizaj, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që argumentojnë gjendjen e konflikti faktik të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Zyrtarja e lartë, znj. Arta Tahiri, është e obliguar që në rast të paraqitjes eventuale të ndonjë situatë me konflikt "rast për rast" të interesit, të bëjë deklarinimin paraprak të interesave private (konform neni 13, paragrafi 1,2,3).

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur pas një lajmërimi - Kërkesë për inicimin e procedurave, nën dyshimin për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-4502-14, për Zyrtaren e lartë, z. Arta Tahiri – Këshilltare Komunale në Komunën e Ferizajt, dhe njëkohësisht e punësuar në pozitën e punës Projekt Menaxhere në Kopshtin e fëmijëve "Lagjja e re" - "Caritas Kosova".

Në rastin me numër protokolli i AKK-03-4502-15, të dyshuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, pas procedurës së shqyrtimit, kemi konstatuar se nuk ka pasur prova të mjaftueshme që argumentojnë gjendjen e konflikti të interesit.

Zyrtarja e lartë, znj. Tahiri, është Këshilltare komunale në Komunën e Ferizajt, e njëkohësisht ushtron edhe pozitën si Menaxhere e projektit në Kopshtin e fëmijëve "Lagjja e re" "Caritas Kosova".

Në bazë të kontratës së punës së z. Arta Tahiri, shihet se ajo për punën e vet i raporton Caritas Kosova, ndërsa Drejtor Gjeneral dhe përfaqësues i "Caritas Kosova" është Don Viktor Sopi.

Po ashtu, në bazë të Marrëveshjes së Bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit në mes të Komunës së Ferizajt dhe "Caritas Kosova" kuptohet se implementues i këtij projekti është Caritas Kosova. Ndërsa për implementimin sa më të mirë të këtij projekti, "Caritas Kosova" do të bashkëpunoj

ngushtë me Kabinetin e Kryetarit të Komunës, Drejtorinë e Arsimit në Ferizaj dhe me partnerët tjerë të cilët do të jenë të involvuar në këtë projekt.

Nga takimi me znj. Tahiri si dhe nga shkresa e saj zyrtare lidhur me këtë rast (Dpk-dpki-02/780/15), kemi kuptuar se ekziston një marrëveshje në mes të Komunës së Ferizajt dhe Organizatës humanitare “Caritas Kosova” (DPK/DPKI-03-02/1024/15) e plotësuar me 04.02.2015, sipas të cilës (Neni 6 i marrëveshjes) përgjegjësinë kryesore për menaxhimin e resurseve njerëzore dhe organizative e ka “Caritas Kosova”.

Ushtrimi i këtyre dy funksioneve mund të sjell eventualisht ndonjë situatë të konfliktit të interesit “rast për rast”, por në bazë të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit, neni 13, paragrafi 1, në këto situata zyrtari/ja është i/e obliguar që të bëjë deklarimin paraprak, “rast për rast” të interesave të saj private.

Në rrethanat aktuale, e vetmja situatë kur në lidhje me aktivitetin e “Kopshtit të fëmijëve në Lagjen e re” vendosë Kuvendi Komunal është të caktimi i çmimit për participim të fëmijëve dhe në këtë situatë e shohim si konflikt “rast për rast” të interesit.

Kjo pra është e rregulluar me nenin 13 paragrafi 1, 2, 3, në të cilin shprehimisht thuhet:

1. Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publike, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij private lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit.

2. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari i lartë, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni mbikëqyrës. Deklarimi si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur.

3. Vetë deklarimi si rregull bëhet me shkrim, kur zyrtari i lartë përfshihet në një vendimmarrje për ndonjë çështje të caktuar.

Po ashtu Ligji Nr.03/L-040, Për vetëqeverisjen lokale, në katër paragrafë të nenit 38 e rregullon çështjen e konfliktit të interesit si vijon :

38.1 Anëtari i kuvendit të komunës apo anëtari i komitetit nuk mund të jetë pjesëmarrës në marrjen e vendimeve dhe në procedurat administrative që kanë të bëjnë me cilëndo çështje në të cilën ai ose ajo, apo ndonjë anëtar i afërt i familjes së tij apo saj, ka interes personal apo material.

38.2 Çdo anëtar duhet t’i shfaqë të gjitha konfliktet e interesit që lindin në çdonjërin prej mbledhjeve në të cilën është present. Çdo këshilltar mund të ofrojë informacione për interesat e anëtarit tjetër.

38.3 Para mbledhjes së parë të kuvendit të komunës, anëtarët e kuvendit duhet t’i regjistrojnë deklaratat e plota dhe të hapura rreth interesave të tyre financiare në një regjistër publik të cilin e mbanë shefi i administratës dhe personelit. Anëtarët duhet të shënojnë çdo ndërrim të gjendjes së tyre financiare posa ato të ndodhin.

38.4 Statuti dhe Rregullorja e punës përcaktojnë masat që masat për përjashtimin e anëtarëve nga

procesi i marrjes së vendimeve dhe nga procedurat administrative, aty ku kanë konflikt të interesit.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

